

Racionalizimi i administratës publike në Maqedoni

Hyrje

Procesi i racionalizimit është inicuar si rezultat i joefikasitetit të organizatave publike në përmbushjen e përgjegjësiave të tyre në mënyrë efektive. Subjektë nëpër tërë botën përfshirë edhe ata publikë perceptojnë racionalizimin si katalizator të reformave organizative. Duke pasur në konsideratë punësimin e një numri shumë të lartë të popullatës në sektorin publik, dimenzioni i burimeve njerzore në restrukturimin e sektorit publik është bërë aktivitet shumë i rëndësishëm nacional si dhe një detyrë komplekse dhe e vështirë për t'u përmbushur. Nga kjo që u tha, automatikisht derivohet fakti që racionalizimi është shëndrruar në një përpjekje të madhe reformash në çdo shtet që pretendon të jetë në shërbim të qytetarëve.

Racionalizimi ka të bëjë kryesisht me zvogëlimin e fuqisë punëtore ose zvogëlim dhe eliminim të funksioneve, shpenzimeve si dhe redizajnim të politikave. Në disa raste, nuk përjashtohet as rritja e fuqisë punëtore. Racionalizimi gjithashtu bën klasifikimin ndërmjet punës së nevojshme dhe të panevojshme si dhe përmirëson dhe prioritetizon punët më të rëndësishme. Ky proces paraqet një përpjekje komplekse për të redizajnuar dhe restrukturuar sektorin publik në tërësi.

Rasti i Maqedonisë

Autoritetet e Maqedonisë gjithashtu ballafaqohen me detyra të vështira në zvogëlimin dhe përmirësimin e efikasitetit të sektorit publik të stërngarkuar.

Pa dyshim, një ndër pengesat kryesore në vendosjen e një sistemi të administratës publike efikase dhe funksionale në Maqedoni paraqitet struktura punëtore joadekuatë. Kjo dëshkohet me anë të hulumtimit tonë i cili rezultoi në këto të dhëna: Enti për veterinarin pranë Ministrisë së bujqësisë, pylltarisë dhe të ujërave për shkak të mungesës së fuqisë së nevojshme punëtore ballafaqohet me probleme të jashtëzakonshme në mbulimin e tërë territorit me inspekcione veterinerë. I njëjti problem vlen edhe për Inspektoriatin e punës, dmth numri i inspektorëve të punës në disa rajone duhet detyrimisht të rritet me qëllim që të mundësohet një mbulesë e tërë e territorit me inspekcione pune.

Raste më të njohura për tepicë punëtorësh egzistojnë në sektorin e arsimit dhe shëndetësisë. Këto sektorë konstituojnë një përqindje të konsiderueshme të numrit të përgjithshëm të të punësuarve në sektorin publik.

Strategjia e racionalizimit

-Strategjia e zvogëlimit të forcës punëtore parimisht fokusohet në uljen e numrit të të punësuarve dhe zakonisht implementohet nga lart-poshtë. Praktikën më të preferuarë për zbatim të kësaj strategjie janë transferet, mosplotësimi i vendeve vakante, ofrimi i masave stimuluese për pensionim të hershëm si dhe nxjerrjet nga puna si një praktikë më ekstreme.

-Strategjia për redizajnim të punës fokusohet në zvogëlimin e punës në vend të zvogëlimit të fuqisë punëtore. Kjo strategji përfshin: eliminimin e posteve dhe departamenteve të tepërta, redizajnim të detyrave, bashkim të njësi apo departamenteve etj.

-Strategjia sistematike ndryshon plotësisht nga strategjitë e mëparshme. Kjo strategji perceptohet si metodë subjektive për të ndikuar në kulturën, qëndrimet dhe vlerat e

punëtorëve në vend të koncentrimit strikt në zvogëlim të punëve apo fuqisë punëtore. Për më tepër, kjo strategji nuk konsiderohet vetëm si program apo qëllim që duhet arritur, por si një proces permanent që konsiston në përmirësim të vazhdueshëm.

Shënime përfundimtare

Procesi i racionalizimit të administratës publike padyshim kërkon përkushtim të madh dhe përpjekje serioze nga të gjithë faktorët e involvuar politik. Por, paradoksi që po ndodh me deklarin e vullnetit për racionalizim ndërsa në anën tjetër punësim masiv të popullatës në sektorin publik paraqet problem serioz me të cilin qartë reflektohet mosekzistimi i vullnetit politik në fillimin e këtij procesi.

Sidoqoftë, tashmë është evidente që Maqedonia detyrimisht duhet të fillojë me racionalizimin e administratës publike, sado që i vështirë dhe i dhimbshëm të jetë ky hap. E gjithë kjo duhet të bëhet me qëllim të përafrimit të administratës publike në Maqedoni me standardet e vendosura nga UE si: shpenzime të ulëta publike, sistem të orientuar kah qytetarët si dhe sektor publik të depolitizuar.

Programi per politika publike dhe administrate

Publikime te ardhshme:

“Decentralizimi fiskal”

Kontakt

Analitika

Dame Gruev 7-8/3
1000 Shkup, Maqedoni
tel: + 389 2 312 1948
web: www.analyticamk.org
info@analyticamk.org

Person pergjegjes per Programin per politika publike dhe administrate

Agim Selami - hulumtues
aselami@analyticamk.org

Analitika - organizate e pavarur joprofitabile e perkushtuar per te ndihmuar persona dhe institucione ne perforcimin dhe permiresimin afatgjate te demokracise dhe udheheqjes si ne R. e Maqedonise ashtu edhe me gjere ne rajon.

Analitika eshte organizate per analize dha hulumtim te politikave publike (think-tank), e perkushtuar ne promovimin dhe zhvillimin e bashkpunimit ndermjet subjekteve dhe organizatave ne R. e Maqedonise dhe me gjere.